



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 364 / Prot.  
10

Tiranë më 27.07.2020

URDHËR

Nr. 132, datë 27.07.2020

PËR KONTROLLUESIN "BELLISTER CALL SHPK"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim, "*Ligji*"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Bellister Call*" SHPK,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 58, datë 02.03.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "*Komisioneri*"), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Bellister Call*" SHPK (në vijim, "*Kontrolluesi*"), me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi "*Bellister Call*" SHPK.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi ushtron aktivitet tregtar në fushën e *call center*, nga data 02.08.2016 dhe në vijim.
2. Kontrolluesi ka në administrim dhe përdorim një sistem video survejimi dhe afati i ruajtjes së imazheve është 30 ditë. Në zyrën e administratës rezultoi e vendosur një kamera, e cila monitoron mjedisin e punës. Kontrolluesi, nëpërmjet sistemit të video survejimit, përpunon të dhënat për kategorinë e subjekteve të të dhënave punëmarrës brenda ambientit të punës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 5 të Ligjit, Udhëzimit

nr. 3, datë 05.03.2010, të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”), dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat” (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se instalimi i sistemit të video survejimit, në ambientet e punës së punëmarrësve, cenon privatësinë e këtyre të fundit dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë së përpunimit të të dhënave, të sanksionuar në germën “c” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit, pasi sistemi i video survejimit duhet të konsiderohet si mjete i fundit për të realizuar qëllimin e përpunimit.

Instalimi dhe përdorimi i sistemit të video survejimit duhet të bëhet në atë formë që përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, të drejtën për privatësi dhe të drejtën për jetë private dhe familjare.

Për përpunimin e të dhënave me anë të sistemit të video survejimit, duhet që lloji, specifikimet e kamerave dhe vendosja e tyre të jenë në përputhje me qëllimin për të cilin do të përdoren. Kamerat nuk duhet të pozicionohen dhe të marrin imazhe nga ambiente të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes.

Kamerat mund dhe duhet të përdoren në mënyrë që të synojnë vetëm identifikimin e qartë të problemeve të sigurisë, duke zvogëluar sa më shumë të jetë e mundur regjistrimin e imazheve të panevojshme për qëllimin e përpunimit. Kjo përqsasje jo vetëm që zvogëlon shkeljet e mundshme të privatësisë, por gjithashtu mundëson përdorimin e kamerave CCTV në mënyrë më efektive.

3. Kontrolluesi informon subjektet e të dhënave në lidhje me praninë e sistemit të video survejimit, por tabelat informuese nuk janë sipas standardit të Udhëzimit nr. 3.

Standardi i vendosur nuk reflekton elementet e domosdoshme që garantojnë informimin e plotë të subjekteve të të dhënave personale, në përputhje me nenin 18 të Ligjit, duke sjelle si pasojë mungesën e informimit mbi të drejtat ligjore që gëzojnë subjektet e të dhënave në kuadër të përpunimit nëpërmjet sistemit të video survejimit.

Në lidhje me sistemin e video survejimit, Kontrolluesi pretendon se kamera, e vendosur në ambientin e zyrës së administratës, është e përligjur për shkak se aty ndodhet dokumentacioni i rëndësishëm i shoqërisë dhe se nuk gjendet në kushtet e përjashtimit të cituar në pikën 5 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit (e cila sanksionon se është e ndaluar mbikëqyrja dhe regjistrimi në ambiente private si dhoma zhveshje ose sanitare).

Zyra e Komisionerit vlerëson se këto raste janë indikative dhe jo shteruese. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave nëpërmjet sistemit të video survejimit duhet t’i nënshtrohet kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 3 dhe Udhëzimin nr. 11 të Komisionerit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 18, 29, 30 pika 1, germa "b" dhe 32 të Ligjit,

### URDHËROJ:

1. Kontrolluesi të realizojë në mënyrë të menjëhershme ndërprerjen e përpunimit të të dhënave imazhe-video të subjekteve të të dhënave, duke hequr kamerën e cituar në pikën 2 të këtij Urdhri, e cila është në tejkalim të qëllimit të përpunimit të parashikuar në germën "c" pika 1 të nenit 5 të Ligjit;
2. Kontrolluesi të shkatërrojë të dhënat imazhe-video të grumbulluara në sistemin e video survejimit (CCTV), siç tregohet në pikën 2 më sipër, në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 të Ligjit;
3. Kontrolluesi të marrë masat për vendosjen e tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejitimit sipas standardit të miratuar në Udhëzimin nr. 3 dhe në zbatim të nenit 18 të Ligjit;
4. Kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 3 dhe Udhëzimin nr. 11;
5. Kontrolluesi të përmbushë detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
  - (i) menjëherë, detyrimet e parashikuara në pikën 1 dhe 2; dhe
  - (ii) brenda 5 (pesë) ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 3.Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
6. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.
7. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky urdhër u shpall sot më 27.07.2020

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

